

Projekti: Mbështetje për Ciklin e Procesit Zgjedhor në Shqipëri

Projekti “Mbështetje për Ciklin e Procesit Zgjedhor në Shqipëri” synon të promovojë një proces zgjedhor demokratik, transparent dhe gjithëpërfshirës në Shqipëri. Kjo iniciativë fokusohet në forcimin e pavarësisë dhe kapaciteteve institucionale të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) si dhe në nxitjen e pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të organizatave të shoqërisë civile dhe mediave në proceset zgjedhore, duke synuar përfshirjen e praktikave të qëndrueshme në administrimin zgjedhor. Rritja profesionale dhe paanshmëria e administratës zgjedhore, si dhe krijimi i një dialogu të strukturuar mes KQZ-së dhe organizatave të shoqërisë civile (OJQ) do të sjellë rritjen e besimit të publikut ndaj procesit zgjedhor, institucioneve dhe legjitimitetit të tyre. Ndërhyrjet e propozuara janë plotësisht në përputhje me prioritetet strategjike të KQZ-së (2022-2026) dhe bazohen në iniciativat dhe ekspertizën e mëparshme të Këshillit të Evropës në fushën e asistencës zgjedhore. Projekti i përbashkët bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Instrumentit për Para-Anëtarësim (IPA) III – Nisma ‘BE për Demokraci’ për të kontribuar në demokracinë gjithëpërfshirëse në Shqipëri në kontekstin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Cilat janë objektivat?

- Forcimi i funksionimit demokratik dhe të pavarur të KQZ-së dhe mbështetje ndaj reformave dhe proceseve të administrimit zgjedhor në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe ato ndërkombëtare;
- Nxitja e pjesëmarrjes dhe kontributit të organizatave të shoqërisë civile dhe të medias në procesin e vendimmarrjes;
- Forcimi i besimit të publikut tek zgjedhjet dhe promovimi i pjesëmarrjes së informuar dhe demokratike.

Cilat janë aktivitetet kryesore?

Projekti do të kontribuojë veçanërisht në garantimin e mëtejshëm të proceseve zgjedhore të lira dhe të ndershme duke:

- Mbështetur krijimin e një Qendre të Pavarur dhe Profesionale të Trajnimit dhe Edukimit të Vazhdueshëm për administratën zgjedhore, së bashku me kapacitetet dhe mjetet përkatëse;
- Rritur transparencën mbi financimin e partive politike dhe parandalimin e keqpërdorimit të burimeve shtetërore përmes forcimit të

Kush përfiton?

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Shqipëri;
- Anëtarët e administratës zgjedhore;
- Organizatat e shoqërisë civile;
- Organizatat e medias / Gazetarët;
- Të rinjtë, votuesit e rinj dhe ata që votojnë për herë të parë, gratë, minoritetet, personat me aftësi ndryshe dhe grupet e tjera vulnerabël;
- Qytetarët e Shqipërisë.

kapaciteteve dhe mekanizmave mbikëqyrës të KQZ-së;

- Forcuar kuadrin rregullator dhe masat mbrojtëse të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të KQZ-së;
- Përmirësuar edukimin e votuesve dhe pjesëmarrjen gjithëpërfshirëse në zgjedhje;
- Institucionalizuar dhe forcuar dialogun konsultues mes KQZ-së, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave;
- Fuqizuar kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave për t’u angazhuar në mënyrë efektive në formësimin e politikave, raportimin dhe monitorimin e

proceseve zgjedhore, edukimin zgjedhor, e te tjera, në përputhje me standardet evropiane.

Cfarë presim të arrijmë?

- Kapacitetete të përmirësuara institucionale të KQZ-së dhe qeverisje më demokratike;
- Pjesëmarrje e lartë e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave në mbikëqyrjen e proceseve zgjedhore dhe formësimin e politikave;
- Përmirësim të besimit të publikut në proceset dhe institucionet zgjedhore;
- Mbulim mediak më të balancuar dhe vendim-marrje të informuar nga votuesit.

Buxheti:

- Buxheti total: 2,223,000 EUR, bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (90%) dhe Këshilli i Evropës (10%).

Kohëzgjatja:

- Kohëzgjatja e nismës është 36 muaj, korrik 2025 deri më korrik 2028) dhe do të zbatohet nga Këshilli i Evropës.

Si do të zhvillohet?

- Përmes një kombinimi aktiviteteve të përshtatura për zhvillimin e kapaciteteve, krijimin e metodologjive të reja të trajnimit dhe edukimit të vazhdueshëm, trajnimit të trajnerëve, zhvillimin e kurikulave përmes mjeteve elektronike;
- Mbështetje ndaj organizatave me grante;
- Mbështetje përmes mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, hulumtive, aktiviteteve ndërgjegjëse, rrjetëzimit dhe shkëmbime mes palëve.

Për më shumë informacion:

- Asamblea Parlamentare e Këshillit të Evropës
- Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë
- Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

Projekti bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe zbatohet nga Këshilli i Evropës.